



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 13 datë 31.1.2023

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.27, DATË 01.06.2016 ‘PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ARTISTIKO – KULTUROR, SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE KULTURORE , ARTISTIKE, SPORTIVE DHE RINORE NË BASHKINË SHKODËR ”I NDRYSHUAR.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 31.1.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenet 25, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; pika nr.1 e VKM-së nr.540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e këshillave artistiko-kulturorë dhe shpërblimin e anëtarëve të tyre” të ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve nr.1, datë 24.05.2005 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko – kulturor”, VKB-në nr.27, datë 01.06.2016 ‘Për ngritjen e këshillit artistiko – kulturor,shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore,artistike,sportive dhe rinore në bashkinë Shkodër ” i ndryshuar , VKB -në nr 71 datë 27.12.2022 “ Per miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesem perfundimtar 2023 -2025 të Bashkise Shkodër” si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Në VKB së nr.27, datë 01.06.2016 ” Për ngritjen e këshillit artistiko – kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore , artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër ”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si me poshtë:

- 1.1 Ngritjen e këshillit artistiko-kulturor në bashkinë Shkodër për dy vitet e ardhshme 2023 -2025, i përbërë nga këto anëtarë :

1.

<i>Nr</i>	<i>Emër Mbiemër</i>	<i>Aktiviteti i tyre ne sherbim te artit kultures dhe sportit.</i>
1	Ridvan Karakaci	Muzikolog, dhe kritik arti
2	Roland Guli	Kompozitor dhe pedagog i pedagogjisë muzikore,

3	Andreas Dushi	Shkrimtar dhe Editor i EX Libris, gazete kombëtare letrare-kulturore e përjavshme, studiues pranë Bibliotekës Kombëtare.
4	Artan Kalaja	Sportist dhe pedagog i shkencave të edukimit.
5	Arbana Halili	Aktiviste e njohur dhe përfaqësuese e shoqërisë civile.
6	Andrea Marko	Muzikant, solist dhe figurë e spikatur në formacionet orkestrorë të bashkisë Shkodër ndër vite.
7	Brunilda Lleshi	Përgjegjës, Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore, Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.

1.2. Burimi i financimit do të jetë buxheti i Bashkisë Shkodër i miratuar me VKB -në nr. 71 datë 27.12.2022 “ Per miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesem perfundimtar 2023 -2025 te Bashkise Shkodër”.

2. Pikat e tjera të VKB- së nr.27, datë 01.06.2016, i ndryshuar mbeten në fuqi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR


Brisela KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 1

Zbardhur me datë 3.2.2023